

AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
**“L&D trading 2020“ shpk**

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Biznesit , Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin “L&D trading 2020“ shpk

*KREU I*

Neni 1  
Emertimi

Shoqeria do te emertohet “**L&D trading 2020**“ shpk dhe eshte person juridik i te drejtes shqiptare,

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “L&D trading 2020“ shpk është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetem, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen; Mursi, rruga Mursi-Konispol km.1, objekti nr.3  
Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4  
Objekti i veprimtarise

Shitje me shumice dhe pakice te amballazheve plastike, ...etj.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.



*KREU II  
KAPITALI*

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000. leke  
Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar nga “ortaku i vetëm” i shoqëisë:

**z. Ledjo Dervishaj**, zoterues i 1 (nje) kuote, me vlerë te pergjithshme 100,000. leke qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku pergjigjet për humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise; Kapitali i shoqerise do te hidhet ne Banke pasi te dali NIPT-i i shoqerise .

Neni 7  
Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombëtare te Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

*KREU II  
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

Neni 8  
Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendsos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistraura në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

#### Neni 9

##### Administrimi

Administrator i shoqerise eshte znj. Ledjo Dervishaj, atesia Leonidha, i datelindjes 02.05.1986, lindur ne Vlore, shtetas Shqipetar madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit te shtetit shqiptar me nr I60502129Q, emeruar ne kete detyre per një afat 5 vjecar me te drejte riparteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

#### Neni 10

##### Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendsura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpérndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 11

#### Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 13  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.  
Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14  
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te njejtave juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "**L&D trading 2020**" shpk nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale .

*ORTAKU I VETEM*

*Ledjo DERVISHAJ*



*Date: 03/09/2020*